



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 04.06.2020 (Pika 1)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 4 qershor 2020 fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami e cila prezanton 7 pikat e rendit të ditës të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen plenare.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton shkurtimisht mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (çështje e shqyrtuar fillimisht në mbledhjen e datës 28.05.2020).

Zoti Toska rikujton se për këtë pozicion të lirë të shpallur me vendimin nr. 90, datë 26.02.2020 kanë kandiduar zonja {...}, znj. {...} dhe znj. {...}. Shqyrtimi i këtij

projektvendimi është ndërprerë mbledhjen e kaluar, për shkak se Këshilli, në interpretim të pikës 6 të nenit 48 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, konsideroi që të ftojë zonjën {...} të përcaktojë në mënyrë të qartë pozicionin e tretë për të cilin ajo kandidon.

Zoti Toska informon se nga ana e zonjës {...} (me e-mailin e datës 29.05.2020) është përcjellë qëndrimi i saj për përcaktimin e pozicionit të lirë të tretë për të cilin ajo kandidon dhe që është pozicioni i lirë i shpallur me vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të KLGJ-së. Ky qëndrim i zonjës {...}, përkon edhe me qëndrimin e vetë Komisionit në rastin e paraqitjes së projektvendimit që është në shqyrtim.

Në këto kushte, mund të vijohet me shqyrtimin e projektvendimit të propozuar.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit projektvendimi “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me

Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr. 89, datë 26.02.2020, si dhe për kandidaten znj. {...}, e cila ka aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Edhe në këtë rast, sikundër në rastet e projektvendimeve të tjera për fillimin e procedurës së verifikimit për tre pozicionet e mëparshme të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Komisioni ka përgatitur të njëjtin aktin sa i përket edhe pozicionit të lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me këtë pozicion, zoti Toska informon se kanë kandiduar brenda afatit të

kandidimit që ka përfunduar më datë 20.05.2020, vetëm 2 kandidate, znj. {...} dhe znj. {...}. Zonja {...} kandidon rishtazi për ngritjen në detyrë për 1 pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo rrethanë është reflektuar në vendim pasi implikon detyrimin e Këshillit për të caktuar relatorin në lidhje me verifikimin e kritereve ligjore të kandidimit sa i përket kësaj kandidateje.

Ndërsa lidhur me kandidaten tjetër, ajo është në proces verifikimi e sipër për dy pozicionet e tjera të lira të shpallura më herët (nr. 88 dhe nr. 90), ndaj përfundimet e verifikimit të filluara më herët do të jenë të vlefshme edhe për verifikimin e kritereve ligjore edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020.

Baza ligjore dhe arsyetimet për propozimet e bëra nga ana e Komisionit janë të njëjta, sikurse u theksua edhe më lart, si në rastet e mëparshme.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj fillimisht, zhvillohet procedura shorti për caktimin e relatorit për kandidaten e vetme që ka kandiduar rishtazi për ngritjen në detyrë për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, pra për znj. {...}, duke u futur në një vazo të tejdukshme shiritat e letrës me emrat e 3 anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Procedura e futjes së emrave në vazo kryhet duke u shfaqur çdo shirit me emrin e kandidatit dhe relatorit në kamera.

Pas procedurës së shortit, rezultati është si më poshtë:

Anëtari zoti Ilir Toska do të jetë relator për: znj. {...}.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit projektvendimi “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska.

3. Për kandidaten znj. {...}, e cila ka aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr. 90, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Ilir Toska** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 9. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti *Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndër të tjera, zoti Toska parashtroi fillimisht disa nga përgjegjësitë që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore, përgjegjësi të cilat gjejnë rregullim në nenin 85, pika 2 dhe 3, si dhe në nenin 86, shkronja “ç” të ligjit nr. 115/2016, gjithashtu gjejnë rregullim edhe në ligjin 96/2016 në nenin 48, pika 11, ndërkohë që në pikën 7 të kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të

specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Ndërkohë, në lidhje me verifikimin e kandidatëve, përfshirë edhe për ata për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019.

Ndaj, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës administrative) dhe me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile), procedura për të cilat ka përfunduar afati i kandidimit më datë 26.05.2020.

Gjithashtu, po referuar Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet 83 dhe 86, datë 26.02.2020, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Po referuar këtij akti nënligjor, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë faktin se, referuar kandidatëve për secilin pozicion të lirë të shpallur me Vendimet 83 dhe 86, datë 26.02.2020, në total 12 kandidatë, rezulton se 11 nga ata, me përjashtim të kandidatit z. {...}, janë në proces e sipër të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të hapura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, sipas Vendimit nr. 151, datë 06.05.2020 të KLGJ-së. Për rrjedhojë, mbetet vetëm një kandidat, z. {...}, për të cilin duhet të caktohet relatori që do të kryej verifikimin e plotësimit nga ai të kriterëve ligjore të kandidimit tij në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për të cilën ka aplikuar, pikërisht për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 85, datë 26.02.2020. Ndërkohë, për 11 kandidatët e tjerë, verifikimet që janë në proces e sipër, pra ato për kandidimet e tyre për një apo të dy pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, janë të vlefshme edhe sa i përket kandidimeve nga ata për një ose të dy pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020.

-Rezulton se kandidati z. {...} ka aplikuar për ngritjen në detyrë për gjashtë pozicione të lira, të hapura me Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87,

datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

-Gjithashtu rezulton se kandidatja znj. {...} ka aplikuar për ngritjen në detyrë në pesë pozicione të lira, të hapura me Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

-Gjithashtu rezulton se kandidatja znj. {...} ka aplikuar për ngritjen në detyrë në katër pozicione të lira, të hapura me Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 85 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kushtet kur kandidatët z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} kanë kandiduar në gjashtë, pesë dhe katër procedura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, të hapura më datë 26.02.2020, ndërsa ligji kufizon të drejtën e kandidimit deri në tre pozicione, ndërkohë që aplikimet e tyre janë konsideruar në procedurat e hapura për pozicionin e parë dhe të dytë të lirë (sipas Vendimeve nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020), Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideroi t'i ftojë këta kandidatë për të përcaktuar pozicionin e tretë nga z. {...}, pozicionin e dytë dhe të tretë nga znj. {...} dhe pozicionin e tretë nga znj. Xhaxho.

Në përgjigje të ftesës së bërë nga Komisioni, zoti {...} ka sjellë përgjigjen e tij, ku ndër të tjera sqaron se: *“... ‘pozicion’ – për rastin e kandidimit tim - është kalimi nga një gjykatë – në të Apelit që jam unë – në një gjykatë të një niveli më të lartë si ajo e Gjykatës së Lartë, për të cilën unë kandidoj.*

Përcaktimi i ‘fushës së të drejtës civile apo administrative’ në Gjykatën e Lartë, nuk bën që të konsiderohet secili nga ato një ‘pozicion’ i veçantë dhe për këtë të përbëjë pengesë parashikimi se “[...] kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira [...]” (§6, neni 48, ligji n.96/2016).

Rrjedhimisht kandidimi im që është ai i ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, pra ‘kalimi nga pozicioni në sistemin gjyqësor që mbaj në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në pozicionin tjetër të një niveli më të lartë të Gjykatës së Lartë’, sipas kuptimit të germës ‘a’ të §1, të nenit 47 të ligjit n.96/2016, në të gjashtë rastet e njoftimit n.82, n.83, n.84, n.85, n.86, dhe n.87, datë 26/02/2020 të KLGJ, është kandidimi për ‘një pozicion’ në Gjykatën e Lartë’ dhe jo për ‘disa pozicione’ në Gjykatën e Lartë’.

Rrjedhimisht interpretimi konfondues i ‘pozicionit’ me ‘rastet e kandidimit’ për të

njëjtin pozicion në Gjykatën e Lartë, përveçse është 'dashakeqës' dhe bie ndesh me parimet e konkurrimit, është një interpretim në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë i rrëzueshëm në Gjykatë."

Në përgjigje të ftesës së bërë nga Komisioni, zonja {...} ka sjellë përgjigjen e saj, ku ndër të tjera sqaron se: *"...Nëpërmjet këtij komunikimi, më lejoni të sjell në vëmendjen Tuaj, se kam kandiduar vetëm për një pozicion të ngritjes në detyrë në shkallën më të lartë dhe që është ai i Gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, i shpallur prej Jush në pesë vende të lira me pesë vendime të ndryshme.*

Neni 47, pika 1, i ligjit 96/2016 parashikon kuptimin e termit 'Ngritja në detyrë', që përkon më rastin tim. ... (vijon). ... Në përputhje me këtë dispozitë ligjore, dhe duke e kuptuar ashtu siç ligjvënësi e ka shkruar vullnetin e tij, kam kandiduar vetëm për një pozicion, sipas parashikimit të shkronjës a), të pikës 1, të nenit 47 të ligjit 96/2016, e konkretisht për ngritje në detyrë për të kaluar nga pozicioni i gjyqtares në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në pozicionin e një niveli më të lartë siç ajo e gjyqtares në Gjykatën e Lartë.

Për më tej, neni 48 pika 1 e ligjit nr. 96/2016, parashikon taksativisht se cilat janë pozicionet e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuar duke përcaktuar si të tilla pozicionet në: 1. Gjykatën e Lartë, 2. Prokurorinë e Përgjithshme dhe 3. Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe, 4. në Gjykatën e Shkallës së Parë të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, të cilat plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, që sipas rregullit të përcaktuar në pikën 6 të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016, nuk lejohet të kandidohet njëkohësisht për të katër këto pozicione, por vetëm në tre prej tyre.

... Në lidhje me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, KLGJ ka shpallur gjashtë vende të lira për pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë për fushën civile dhe fushën administrative, për të cilat unë kam shprehur interesin duke konkurruar pesë herë por vetëm për një pozicion të ngritjes në detyrë: me kërkesën e qartë për të kaluar nga gjyqtare e gjykatës së apelit të posaçëm në gjyqtare të Gjykatës së Lartë. ...

... Ndërsa në përgjigje të ftesës Tuaj, për të përcaktuar preferencën e kandidimit,

rendis të parat vendet e lira të në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Në përgjigje të ftesës së bërë nga Komisioni, znj. {...} ka sjellë përgjigjen e saj, ku ndër të tjera sqaron se: *“Në përgjigje të emal-it ju sqaroj se pozicioni i tretë për të cilin kandidoj është: Pozicioni i shpallur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në fushën e të drejtës administrative).”*

Komisioni, ashtu si edhe në rastin e zonjës {...}, konsideroi t’i kërkonte një opinion ligjor Misionit EURALIUS, opinion i cili rezulton i njëjtë me opinionin e dhënë nga vetë KZHK lidhur me interpretimin e pikës 6 të nenit 48 të ligjit për Statusin, ku ligji i referohet qartësisht një maksimumi prej tre pozicioneve, dhe jo gjykatash për kandidim për ngritje në detyrë dhe në total kandidati mund të aplikojë për jo më shumë se 3 pozicione të lira ose që priten të bëhen të lira, pavarësisht nëse janë në të njëjtën gjykatë apo jo. Ndërkohë që në rastin kur kandidati kandidon në më shumë se një pozicion, ai ka detyrim të bëjë edhe renditjen e tyre sipas preferencës. Qëllimi i këtij kufizimi ligjor është shmangia e vonesave dhe e ndërlikimeve gjatë procedurës së ngritjes në detyrë.

Mbi këtë interpretim, në lidhje me pozicionin e tretë për të cilin duhet të konsiderohet kandidimi i z. {...}, KZHK vlerëson se si pozicioni i tretë për të cilin ka aplikuar kandidati z. {...} të konsiderohet ai që i korrespondon procedurës së ngritjes në detyrë të hapur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020. Ky kandidim është i pari në radhë në raport me kandidimet e mëpasshme për tre pozicionet e tjera të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të hapura me Vendimet nr.84, nr.86 dhe nr.87, datë 26.02.2020. Nga ana tjetër, përcaktimi në këtë mënyrë të pozicionit të tretë për të cilin kandidon z. {...} e bën atë jokandidat për pozicionet e lira për këto procedura ngritjeje në detyrë, pra për ato sipas Vendimeve nr.84, nr.86 dhe nr.87, datë 26.02.2020.

Mbi këtë interpretim, në lidhje me pozicionin e dytë dhe të tretë për të cilët duhet të konsiderohet kandidimi i znj. {...}, KZHK vlerëson se si pozicioni i dytë dhe i tretë për të cilët ka aplikuar kandidatja z. {...} të konsiderohen ato që i korrespondojnë procedurave të ngritjes në detyrë të hapura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020. Këto kandidime janë të parët në radhë në raport me kandidimet e mëpasshme për dy pozicionet e tjera të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të hapura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020. Nga ana tjetër, përcaktimi në këtë

mënyrë të pozicionit të dytë dhe të tretë për të cilët kandidon znj. {...} e bën atë jokandidate për pozicionet e lira për këto procedura ngritjeje në detyrë, pra për ato sipas Vendimeve nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.

Gjithsesi i takon Këshillit që, sikundër edhe në rastin e kandidatës znj. {...}, të ftojë përsëri kandidatin z. {...} për të përcaktuar në mënyrë të qartë pozicionin e tretë për të cilin kandidon për ngritjen në detyrë, si dhe kandidaten znj. {...} për të përcaktuar në mënyrë të qartë pozicionin e dytë dhe të tretë për të cilët kandidon për ngritjen në detyrë.

Nëse Këshilli konsideron të ezauruar ftesën për kandidatët z. {...} dhe znj. {...}, atëherë ai mund të procedojë me shqyrtimin e projektvendimit të paraqitur sot në mbledhje.

Ndërsa lidhur me gjyqtaren {...} e cila ka përcaktuar në mënyrë të qartë tre pozicione të lira për të cilat kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, del qartë se për aplikimin e saj për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 86, datë 26.02.2020 nuk klasifikohet si kandidate për ngritjen në detyrë, shkak për të cilin në projektvendimin e propozuar nuk ka disponim të veçantë për të.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga shtatë pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.83, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për kandidatin e vetëm që ka kandiduar rishtazi për ngritjen në detyrë për një nga pozicionet e lira sipas Vendimeve nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, pra për z. {...} (vendimin nr. 83).

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se për znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre, sipas rastit, për një ose të dyja pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020.

Ndërsa pika 4 e projektvendimit bën fjalë për mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

Kurse pika 5 e projektvendimit bën fjalë për mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

Me tej, në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet se disponimi sipas pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi, u njoftohen aplikuesve z. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ndërkohë që në pikën 7 të projektvendimit përcaktohet se aplikuesit z. {...} dhe znj. {...} kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit respektivisht të pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Merr fjalën *zonja Brikena Ukperaj*, e cila fillimisht thekson që mund të ketë një gabim material në pikën 3 të projektvendimit, ku përmendet vendimi nr. 84, pasi vendimi nr. 84 nuk është futur ende në proces dhe pas konfirmimit nga zoti Toska që bëhet fjalë për një lapsus, zonja Ukperaj propozon që të korrigjohet e të bëhet “vendimi nr. 86”.

Më pas, nisur edhe nga diskutimi i zotit Toska, nisur edhe nga qëndrimi që u mbajt në mbledhjen e kaluar, lidhur me kandidaten znj. {...}, ku u vendos që t’i komunikohet njëherë kandidatit qëndrimi i Këshillit dhe më pas të disponohet lidhur me skualifikimin apo mospërfshirjen, lidhur me dy kandidatët z. {...} dhe znj. {...}, pozicionet që kanë aplikuar, janë të ndryshme, janë civil dhe administrativ, ndërsa tek zonja {...} ishte edhe më i thjeshtë diskutimi sepse ishte një pozicion i të njëjtës natyrë, zonja Ukperaj mendon që dy kandidatëve t’u njoftohet vendimi i Këshillit që, ata nuk mundet të aplikojnë në më shumë se tre pozicione, pavarësisht gjykatës dhe llojit të pozicionit dhe madje t’iu njoftohet edhe fakti që nëse ata nuk do të zgjedhin pozicionin e tretë por

do të vazhdojnë të ngrenë pretendime që aplikojnë për të gjitha pozicionet, Këshilli do të mbajë qëndrimin që pozicion të tretë do të konsiderojë pozicionin e shpallur më herët (si numër), -shton zonja Ukperaj, -marrë shkas nga procedura e ndjekur me rastin e ngritjes në detyrë edhe për efekt të ankimimit që mund të kenë kandidatët, por edhe për të zhdukur çdo lloj perceptimi që z.{...} mund të ketë për mënyrën djallëzore të shpalljes së vendeve të lira.

Hidhet në votim propozimi i zonjës Ukperaj që fillimisht të njoftohen dy kandidatët z. {...} dhe znj. {...} (siç ndodhi në rastin e znj. {...}) për të përcaktuar në mënyrë të qartë pozicionin e tretë, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që të ftojë përsëri kandidatët z. {...} dhe znj. {...}, që brenda ditës së nesërme, të përcaktojnë në mënyrë të qartë pozicionin e tretë për të cilin ato kandidojnë.

Projektvendimi i propozuar në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet pasi të vijë përgjigjja nga kandidatët.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues të projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në gjykatën e lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, për kandidatin z. {...}”.

Me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Afati për kandidimin në këtë pozicion ka përfunduar më datë 29.04.2020. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me

Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile) të KLDJ-së, dhe caktimin e relatorit z. Ilir Toska për kandidatin z. {...}.

Gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre prej kritereve ligjore të kandidimit, në përputhje me përcaktimin e pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.85, datë 26.02.2020, pas njoftimit në rrugë elektronike, më datë 22.05.2020, të gjetjes së kësaj procedure në lidhje me kriterin e përvojës specifike profesionale minimale të përshtatshme për pozicionin e lirë, pra atë në fushën e të drejtës civile, më datë 26.05.2020 kandidati ka kthyer përgjigje se: *“Meqenëse, me vendimet nr. 82, 83 dhe 84, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, me qëllim që të shpreh interesin tim për të tre këto pozicione të lira në fushën administrative, shpreh qëndrimin tim për të hequr dorë nga shprehja e interesit për pozicionin e lirë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, në fushën e të drejtës civile, sipas vendimit nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

Në rrethanat sa më sipër, zoti Toska, në cilësinë e relatorit, bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr.75, datë 23.05.2019 ka përgatitur relacionin përkatës dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit të tërhequr dhe duke ia parashtruar rastin KZHK-së.

KZHK, pasi e konsideroi të rregullt procedurën e verifikimit paraprak të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 85, datë 26.02.2020, bazuar në Vendimin 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projektvendimit të propozuar nga KZHK “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 85,

datë 26.02.2020, për kandidatin z. {...}”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

Merr fjalën zoti Alban Toro i cili relatton shkurtimisht relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”.

Ndër të tjera zoti Toro parashtron se me Dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është përcaktuar me 4 gjyqtarë dhe së fundmi KLGJ ka emëruar aty 3 gjyqtarë dhe nga ana e Komisionit është identifikuar 1 pozicion i lirë i përkohshëm në këtë gjykatë.

Me vendimin nr. 175, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i është ripërsëritur afati deri më 15.06.2020 zotit {...}, i cili ushtron detyrën e gjyqtarit në këtë gjykatë, por që vjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Gjithashtu në relacion janë dhënë në mënyrë të detajuar ngarkesa respektive për të dy gjykatat.

Komisioni arrin në konkluzion që i vetmi akt i cili mund të plotësojë nevojat e kësaj gjykate është vendimi nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së, ndaj në këtë kontekst, propozohet që të shpallet një pozicion i lirë i përkohshëm, duke ftuar fillimisht për të

dhënë pëlqimin gjyqtari që është transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Administrative të Shkallës së Parë Shkodër z. {...}, i cili të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni për Zhvillimin e Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projektvendimit të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën

Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

Merr fjalën zoti Alban Toro i cili relatton shkurtimisht relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Ndër të tjera zoti Toro parashtron se me Dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, organika e kësaj gjykate është përcaktuar me 4 gjyqtarë, ku aktualisht në mënyrë të përhershme janë emëruar 2 gjyqtarë.

Me Vendim nr. 98, datë 21.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} i është zgjedhur afati i transferimit të përkohshëm për një periudhë deri në 1 (një) vit. Kjo gjyqtare vjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Gjithashtu në relacion është dhënë në mënyrë të detajuar ngarkesa e gjykatave si dhe fakti që ekziston një pozicion i lirë i përkohshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Komisioni arrin në konkluzion që i vetmi akt i cili mund të plotësojë nevojat e kësaj gjykate është vendimi nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së, ndaj në këtë kontekst, propozohet që të shpallet një pozicion i lirë i përkohshëm.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës së transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, znj. {...}, e cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për kryerjen e procedurave të mëtejshme të transferimit të përkohshëm.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projektvendimit të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.06.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 12:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

Merr fjalën zoti Alban Toro i cili relatton shkurtimisht relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera zoti Toro parashtron se me Dekretin nr.7818, datë 16.11.2012, organika e kësaj gjykate është përcaktuar me 4 gjyqtarë, ku aktualisht janë emëruar në mënyrë të përhershme në funksionin e gjyqtarit 2 gjyqtarë.

Me Vendim nr. 95, datë 21.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...} i është zgjatur afati i transferimit të përkohshëm për një periudhë deri në 1 (një) vit si dhe me Vendim nr. 96, datë 21.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...} i është zgjatur afati i transferimit të përkohshëm për një periudhë deri në 1 (një) vit.

Duke parë nevojat e kësaj gjykate për gjyqtarë për shkak të ngarkesës si dhe duke vlerësuar ngarkesat respektive edhe të gjykatës mëmë, i vetmi akt i cili vjen në ndihmë për plotësimin e nevojës së kësaj gjykate është vendimi nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së, duke kërkuar fillimisht pëlqimin e gjyqtarit që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të

përhershme.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të shpallë dy pozicione të lira pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarëve të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë znj. {...} dhe z. {...}, të cilët të ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për kryerjen e procedurave të mëtejshme të transferimit të përkohshëm.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen në fjalë, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projektvendimit të propozuar nga KZHK “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e projekt-aktit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, sipas propozimit të bërë nga KZHK-ja.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor